

RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR

Drejtuar: Asamblese se Pergjithshme te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar.

Opinion i pakualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar-KOKSH, Organizate jo fitimprurese, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e aktiviteteve, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pasqyrën e pozicionin financiar të KOKSH, pasqyrën e aktiviteteve dhe flukset e parasë me datën 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit per OJF-te të përmirësuara (SKK).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga KOKSH në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje ne nuk japim një opinion të veçantë.

Çështje per tu theksuar

1. KOKSH, pas daljes se Udhezimit te perbashket te Ministrit te Arsimit, Sportit dhe Rinise dhe Ministrit te Financave Nr.4, date 25.02.2020, hyre ne fuqi me botimin ne fletoren zyrtare nr.58, date 03.04.2020, ka nderprere perdorimin e fondeve buxhetore per pagat deri ne sqarimin juridik per zbatimin e ketij udhezimi. Tepriat e paperdorura te fondeve buxhetore jane kthyer ne thesarin e shtetit.



Përgjegjësitë e Administratorit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi (Komiteti Ekzekutiv dhe Stafi) është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të për OJF-te, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare


Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale në pasqyrat financiare, të cilat mund të vijnë si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare me qëllim që të përcaktojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatmërisë së politikave kontabël të përdorura, të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin për paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne kemi përgatitur një leter me disa çështje për Drejtimin dhe Stafin e KOKSH.

2


Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të tij, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Auditues Ligjor

Ludmilla Paluka



Tiranë, më 26 Nentor 2021